



Duke u mbështetur në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/031, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 nen pikën 4) të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 7 të Ligjit nr. 04/L - 071, për sistemin e adresave ('Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës "nr. 29/27, dhjetor 2011), nenin 9 pikën 1.3 të UA Nr.16/2019, nenit 5 pika 1.6 të UA Nr.14/2019, Sipas shkresës së MMPHI-së Nr. DL-2468-2/23 të datës: 24.05.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me 30.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për

Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr.06-14824/2023 për emërtimin e rrugës

1. Plotësohet-ndryshohet Vendimi 01Nr.06-14824/2023 për emërtimin e rrugës në Qytetin e Klinës, sipas shkresës të MMPHI-së me nr.DL-2468-2/2023 i datës: 24.05.2023.
2. Pas miratimit paraprak nga AKK, Kuvendi i Komunës së Klinës miraton kërkesën e DUMM për emërtimin e rrugës me emrin e ish senatorit Willy Kuijpers, rruga do të quhet "Uilli Kuijpers".
3. Segmenti i rrugës së emërtuar si në pikën 2 të këtij vendimi përshkohet nga kryqëzimi i rrugës "Muhamet Haxhaj" deri tek kryqëzimi i rrugës "Ali Kelmendi" në Qytetin e Klinës dhe nuk ka qenë i emërtuar me parë.
4. Rruga emërohet në nderim dhe respekt për humanistin Willy Kuijpers i cili dha kontribut të veçantë për të drejtat e njeriut në Kosovë.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Urbanizmit dhe mbrojtje të Mjedisit;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-22085 /2023
Klinë, me 05.07 /2023



KRYESUESI,
Fadil Gashi